Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0027
Data e Vendimit: 01.01.0001

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit ekonomik (OE) "GUARD DE CAPITAL" SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Sigurimi Fizik i Objekteve për nevojat e UP-së" me numër të prokurimit 242-23-12924-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – "UNIVERSITETI I PRISHTINËS", Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj Mexhuani me 25/01/2024, mori këtë:

Vendim

I.Hedhet si e palejuar ankesa e "GUARD DE CAPITAL" SH.P.K., me nr. të protokollit 2024/0027, e datës 09/01/2023, e parashtruar për aktivitetin e prokurimit "Sigurimi Fizik i Objekteve për nevojat e UP-së", me numër të prokurimit 242-23-12924-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – "UNIVERSITETI I PRISHTINËS".

II. I lejohet, autoritetit kontraktues – "UNIVERSITETI I PRISHTINËS" që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit "Sigurimi Fizik i Objekteve për nevojat e UP-së", me numër të prokurimit 242-23-12924-2-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik e-prokurimi me datë 09/01/2023, tek rubrika e ankesave ka pranuar një ankesë nga OE "GUARD DE CAPITAL" SH.P.K., për aktivitetin e prokurimit me "Sigurimi Fizik i Objekteve për nevojat e UP-së" me numër të prokurimit 242-23-12924-2-1-1, inicuar nga "UNIVERSITETI I PRISHTINËS", në cilësinë e autoritetit kontraktues.

Zyra e pranimit të ankesave pas pranimit të ankesës, gjatë verifikimit nëse ankesa është dorëzuar sipas rregullave dhe dispozitave ligjore, ka konstatuar se ankuesi për ankesën në fjalë, nuk ka ofruar dëshminë e pagesës siç kërkohet me pikën 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së dhe nenin 69 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik.

Nisur nga fakti se ankuesi ankesës së lartcekur, nuk i ka bashkangjitur konfirmimin e bankës për tarifën, zyra për pranimin e ankesave me datën 12/01/2024 përmes email-it e ka njoftuar OE ankues se ankesës së cekur si më lart nuk i ka bashkangjitur formularin për sigurim të depozitës së Ankesës, ta plotësoj ankesën sipas nenit 111 të LPP në të kundërtën hedhet si e palejuar ankesa. Po ashtu i njëjti me po atë datë ka kthyer email me arsyetimin se pagesa do të bëhet brenda ditës ose më së largu të hënën.Por, edhe përkundër këtij njoftimi dhe sqarimi të OSHP-së, OE ankues edhe pas kalimit të afatit ligjor për plotësim të pagesës nuk ka kthyer kurrfarë përgjigje në lidhje me pagesënsipas kërkesës së institucionit.

Nga provat e prezantuara vlerësohet se ankesa e parashtruar nga OE "GUARD DE CAPITAL" SH.P.K., e datës 09.01.2024 (protokoll 0027/2024), për aktivitetin e prokurimit me titull "Sigurimi Fizik i Objekteve për nevojat e UP-së" me numër të prokurimit 242-23-12924-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – "UNIVERSITETI I PRISHTINËS", konsiderohet si e pa kompletuar sepse ankuesi nuk ka deponuar tarifën e sigurimit të ankesës së tij siç kërkohet në piken 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së lidhur me nenin 118 të LPP-së.

Andaj procedura e shqyrtimit të kësaj ankese përfundon në ketë fazë duke e hedhur të njëjtën si palejuar - jo e plotë ngase kjo ankesë nuk plotëson kushtet për tu proceduar më tutje siç kërkohet dispozitat ligjore të lartcekura.

I lejohet, autoritetit kontraktues – "UNIVERSITETI I PRISHTINËS" që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit "Sigurimi Fizik i Objekteve për nevojat e UP-së", me numër të prokurimit 242-23-12924-2-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit. Megjithatë, OSHP gjithnjë niset nga rregullat, zgjidhjet dhe parimet e LPP sipas të cilit secili AK ushtron pavarësinë e tij/sajë në kuptim të nenit 8 dhe 9 lidhur me planifikimin e prokurimit dhe parashikimin e nevojave, mirëpo kriteret e parapara gjithnjë duhet ta garantojnë barazinë e OE të cilët parashihen si të tillë edhe me DT e cila në kuptim të nenit 27, lidhur me nenin 28, përbën dokumentin kyç të prokurimit publik. Prandaj në kuptim të nenit

Neni 51 (Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes) të LPP, sipas të cilit të gjithë kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen *vetëm në kriteret e nevojshme* për të siguruar se vetëm operatorët ekonomik që posedojnë aftësitë e nevojshme profesionale, financiare dhe teknike për ti përmbushur kushtet e kontratës përkatëse do të konsiderohen të kualifikuar për të marrë një kontratë të tillë ose për marrjen e ftesës për tenderim. Dhe se, në asnjë rast, autoriteti kontraktues ***nuk duhet*** <u>që tëpërfshijë, saktësojë ose përdorë kritere të përzgjedhjes që bazohen në konsiderata të tjera përveç atyre të lejuara nga dispozitat e neneve 65-70 të këtij ligji</u>. Andaj Paneli Shqyrtues i vë në dijeni AK se në çdo aktivitet duhet të veproj konfom dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç parashihen ato me nenet 1,6,7, 27,28,51,59,60,65,69,70 të LPP.

Kryetarja e OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vjosa Gradinaj
Kryetare e OSHP-së

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **UNIVERSITETI I PRISHTINËS**
- OE - **GUARD DE CAPITAL SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: